

MINISTRIA E TRANSPORTIT DHE INFRASTRUKTURES

FORMULARI I NJOFTIMIT TE FITUESIT

Për: Anijet e Shërbimit Detar SHA,
Rruga Taulantia, Pallati FLY, Lagja Nr. 1, Durrës

I nderuar z. Hoti,

Në lidhje me procedurën koncesionare “Për dhënien me koncesion të disa shërbimeve detare”, e cila ka si objekt të saj financimin, rehabilitimin, operimin, mirëmbajtjen dhe transferimit të së drejtës së operimit të shërbimit të anijeve detare, për një periudhë 5 vjecare ka përfunduar procesin e vlerësimit të ofertave të paraqitura.

Njoftojmë se, kanë qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues:

1. Gesmar-Gestione Marittime s.p.a, Ocean s.r.l, La Petrolifera Italo Rumena societa per azioni), përfaqësuar nga shoqëria Gesmar
2. Shoqëria Aksionare Anijet e Shërbimit Detar

U skualifikua shoqëria Gesmar-Gestione Marittime s.p.a, Ocean s.r.l, La Petrolifera Italo Rumena societa per azioni për arsyet e mëposhtme:

1. Nuk ka parashikuar Fee- koncesionare në ofertën e paraqitur.
2. Mjetet e ofertuesit nuk janë të regjistruara në Regjistrin e Mjeteve Lundruese në Republikën e Shqipërisë, si përcaktohet në Dokumentet Standarte.

3. Nuk ka paraqitur vërtetim nga organet kompetente për shlyerjen e detyrimeve fiskale dhe sigurimet shoqërore

Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës lajmëron subjektin “Anijet e Shërbimit Detar” SHA, se oferta e paraqitur në datë 20/04/2017 “Për dhënien me koncesion të disa shërbimeve detare” me vlerë 238.374.000 lekë (dyqind e tridhjetë e tetë milion e treqind e shtatëdhjetë e katër mijë) është pranuar.

Afati i negociimit të kontratës tuaj do të jetë 15 ditë nga momenti i njoftimit të fituesit.

Shoqëria Anijet e Shërbimit detar SHA t’i paraqesë Ministrisë së Transportit dhe Infrastrukturës dokumentat e mëposhtëm:

1. Kopjen e vënies në dijeni për Formularin e Kushteve të Përgjithshme dhe të Veçanta të Kontratës Konçesionare\Partneritetit publik Privat, të nënshkruar.
2. Sigurimin e Kontratës, sipas formës së kërkuar në Dokumentet Standarde të Procedurës Konkurruese. Sigurimi duhet të paraqitet jo me vonë se në momentin e nënshkrimit të Kontratës nga të dy palët.
3. Dokumentacionin origjinal të ofertës së dorëzuar në procedurën konkurruese.
4. Në rast se tërhiqeni nga lidhja e kontratës duhet të njoftoni me shkrim.

Njoftimet për kualifikim janë bërë në datë 04.05.2017 me shkrim dhe në sistemin e Agjencisë së Prokurimit Publik. Nuk ka patur ankesa në lidhje me këtë këto njoftime.